

UDHËZUES

mbi Programin e Ricertifikimit
për profesionistët e shëndetësisë



QENDRA KOMBËTARE E EDUKIMIT NË VAZHDIM

UDHËZUES

MBI PROGRAMIN E RICERTIFIKIMIT

PËR

PROFESIONISTËT E SHËNDETËSISË

Janar 2010



QENDRA KOMBËTARE E EDUKIMIT NË VAZHDIM

PUNOI:
Sonila Meçaj

© Të drejtat e këtij botimi i përkasin QKEV-së

Për më shumë informacion kontaktoni:
Qendra Kombëtare e Edukimit në Vazhdim
Rr. "Aleksandër Moisiu", nr.84, Tiranë, Shqipëri.
Tel: +355 4 2452286
e-mail: info@qkev.gov.al
www.qkev.gov.al

*Ky botim është mbështetur nga projekti **“Sistemi për Zhvillim Profesional”**, me fondet e Agjencisë Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim*



Schweizerische Eidgenossenschaft
Confédération suisse
Confederazione Svizzera
Confederaziun svizra

Swiss Cooperation Office Albania
Zyra e Bashkëpunimit Zviceran në Shqipëri

LËNDA

I. HYRJE	9
1. Kuadri ligjor	10
2. Qëllimi i dokumentit	11
3. Konceptet bazë	11
4. Parimet dhe standardet	12
II. NJOHJE E PËRGJITHSHME ME PROGRAMIN E RICERTIFIKIMIT	13
1. Çfarë synon Programi i Ricertifikimit?	13
2. Si është i organizuar Programi i Ricertifikimit?	14
3. Cilët janë hapat që duhet të ndjekin profesionistët për tu përfshirë në Programin e Ricertifikimit?	16
4. Cilat janë kriteret që duhet të plotësojnë profesionistët e përfshirë në Programin e Ricertifikimit?	17
5. Si përfitohen kreditet? Aktivitetet e edukimit në vazhdim dhe kreditet përkatëse.....	20
III. PROCEDURAT E RICERTIFIKIMIT	25
1. Si kryhet regjistrimi në Programin e Ricertifikimit	25
2. Si regjistrohen kreditet?	26
2.1 Aktivitetet e edukimit në vazhdim të akredituara paraprakisht	26
2.2. Aktivitetet e edukimit në vazhdim të paakredituara paraprakisht ...	28
3. Ricertifikimi	31
IV. KËSHILLA PRAKTIKE	33
SHTOJCA	34

SHKURTIME

AEV- Aktivitete të Edukimit në Vazhdim

BKRA – Bordi Kombëtar i Ricertifikimit dhe Akreditimit

ISKSH – Instituti i Sigurimeve të kujdesit Shëndetësor

MSH – Ministria e Shëndetësisë

PR – Programi i Ricertifikimit

PSH - Profesionist i Shëndetësisë

QKEV – Qendra Kombëtare e Edukimit në Vazhdim

QKCSAISH – Qendra Kombëtare e Cilësisë, Sigurisë dhe Akreditimit të

Institucioneve Shëndetësore

FALËNDERIME

Ky udhëzues u përgatit nga Sonila Meçaj, shefe e Sektorit Teknik dhe Pedagogjik, me mbështetjen e Entela Shehut, drejtore e QKEV-së dhe Kristina Vokos, shefe e Sektorit të Akreditimit.

QKEV-ja falënderon Agjencinë Zvicerane për Bashkëpunim dhe Zhvillim për mbështetjen financiare.

I. HYRJE

Një nga sfidat më të rëndësishme të reformës së sistemit shëndetësor shqiptar është përmirësimi i cilësisë së shërbimeve shëndetësore. Ky përmirësim është i lidhur ngushtë me zhvillimin e burimeve njerëzore në sektorin e shëndetësisë. Në këtë kontekst po ngrihet dhe zhvillohet një sistem i edukimit në vazhdim për profesionistët e shëndetësisë, në mënyrë që ata të përmbushin me sukses funksionet e tyre në ruajtjen dhe përmirësimin e shëndetit të popullatës.

Edukimi në vazhdim për profesionistët e shëndetësisë është procesi nëpërmjet të cilit profesionistët e shëndetësisë përfitësojnë dijet dhe aftësitë e tyre, për të plotësuar nevojat e pacientëve, të shërbimeve shëndetësore dhe ato të zhvillimit të tyre profesional. Zhvillimi i tyre profesional lidhet me kontekstin multidisiplinar të kujdesit për pacientin që, përveç njohurive dhe aftësive mjekësore, përfshin edhe aftësitë menaxheriale, sociale dhe personale.

Krahas nevojës për zhvillim profesional, profesionistët e shëndetësisë janë të detyruar të përfshihen në aktivitetet e edukimit në vazhdim për t'iu përgjigjur kërkesave të ricertifikimit dhe rilicencimit të lidhur me të. Gërshetimi i nevojave me detyrimet përbëjnë thelbin e sistemit të edukimit në vazhdim.

Institucionalizimi i edukimit në vazhdim ka në themel të tij zbatimin e programit të ricertifikimit në bashkëpunim me aktorë të tjerë të rëndësishëm të sistemit shëndetësor në këtë fushë, si Ministria e Shëndetësisë, QKEV-ja, institucionet shëndetësore të kujdesit parësor, dytësor e tretësor, urdhrat dhe shoqatat e profesionistëve, fakultetet e mjekësisë dhe infermierisë.

I. Kuadri ligjor

Kuadri ligjor që mbështet programin e ricertifikimit dhe sistemin e edukimit në vazhdim në përgjithësi bazohet në ligjin e ri “Për Kujdesin Shëndetësor në Republikën e Shqipërisë”¹. Neni 33 i tij përcakton detyrimin e profesionistëve dhe institucioneve të shëndetësisë për zbatimin e procesit të edukimit të vazhdueshëm profesional.

Neni 33 : **Edukimi i vazhdueshëm profesional**

1. Ministria e Shëndetësisë krijon programe të detyrueshme për edukimin e vazhdueshëm profesional.
2. Profesionistët e kujdesit shëndetësor janë të detyruar t’i nënshtrohen edukimit të vazhdueshëm profesional të përditësuar, për të përmirësuar njohuritë dhe aftësitë e tyre profesionale, në mënyrë që të rrisin cilësinë e kujdesit shëndetësor.
3. Punësimi, privilegjet ose kontratat në institucionet shëndetësore përfundajnë, nëse stafi profesionist nuk i nënshtrohet procesit të edukimit të vazhdueshëm, të përcaktuar nga Ministria e Shëndetësisë.
4. Institucionet e kujdesit shëndetësor u nënshtrohen sanksioneve në rast se ato punësojnë specialistë, të cilët nuk përmbushin kërkesat e parashikuara në këtë nen.
5. Institucionet e kujdesit shëndetësor lehtësojnë edukimin e vazhdueshëm profesional të profesionistëve shëndetësorë.

Gjithashtu, në bazë të urdhrit nr.554 të ministrit të Shëndetësisë, datë 22.10.2009 “Për miratimin e Dokumentit Rregullator për Ricertifikimin e profesionistëve të shëndetësisë”, institucionet përgjegjëse janë të detyruara të venë në zbatim programin e ricertifikimit sipas kriterëve dhe procedurave të përshkuara në të.

¹ Ligji për Kujdesin Shëndetësor në Republikën e Shqipërisë, nr. 10107, datë 30.03.2009.



2. Qëllimi i udhëzuesit

Së pari, ky udhëzues ka për qëllim të ndihmojë profesionistët e shëndetësisë të njohin kërkesat e programit të ricertifikimit, bazuar në Dokumentin Rregullator për Ricertifikimin e profesionistëve të shëndetësisë, miratuar me urdhrin nr.554 të ministrit të Shëndetësisë, datë 22.10.2009. Gjithashtu, ky udhëzues synon të lehtësojë përfshirjen e profesionistëve në këtë program, duke shpjeguar hapat dhe procedurat që duhen ndjekur në përbushje të kërkesave të ricertifikimit. Ashtu siç parashikohet në dokumentin rregullator, si fillim, profesionistët që do të përfshihen në programin e ricertifikimit janë mjekë, stomatologë dhe farmacistë që ushtrojnë profesionin e tyre në Republikën e Shqipërisë.

Ky udhëzues informon profesionistët edhe mbi përgjegjësitë e tyre në lidhje me vënien në zbatim të programit të ricertifikimit.

3. Konceptet bazë

Aktivitetet e edukimit në vazhdim janë të gjitha aktivitetet të cilat kanë për qëllim të përbushin nevojat e profesionistëve të shëndetësisë në plotësimin e përgjegjësive dhe detyrimeve të tyre profesionale. Disa forma të edukimit në vazhdim janë: trajnimi (nga njëditor deri në tremujor); konferenca; seminari; workshop-i; leksioni/ kolokiumi/ diskutime rasti; aktivitete të të mësuarit në distancë; aktiviteti kërkimor.

Programi i ricertifikimit është sistem i bazuar në cikle periodike, brenda të cilave profesionistët duhet të mbledhin një numër të caktuar kreditesh të edukimit në vazhdim, bazuar në procedurat, kriteret dhe standardet e parashikuara.

Ricertifikimi është dëshmia që profesionisti merr në përbushje të kriterëve të secilët cikël të programit të ricertifikimit.

Pjesëmarrës në programin e ricertifikimit² quhen të gjithë mjekët, stomatologët dhe farmacistët, shtetas shqiptarë dhe të huaj, që ushtrojnë profesionin e tyre në Republikën e Shqipërisë, sipas legjislacionit në fuqi, në institucionet publike ose private të kujdesit shëndetësor parësor, dytësor dhe tretësor dhe ata të institucioneve akademike

² *Infermierët dhe kategori të tjera të profesionistëve të shëndetësisë do të përfshihen gjithashtu në këtë program në të ardhmen.*

shëndetësore.

Akreditimi është procesi i miratimit të aktiviteteve të edukimit në vazhdim nga ana e institucionit akreditues, bazuar në procedurat, standardet dhe kriteret e paracaktuara.

Institucioni akreditues është institucioni që vlerëson përputhshmërinë e aktiviteteve të edukimit në vazhdim me kriteret dhe standardet e miratuara dhe përcakton numrin e krediteve për pjesëmarrësit (profesionistët e sektorit të shëndetësisë).

Ofrues të aktiviteteve të edukimit në vazhdim janë të gjitha institucionet publike ose private, akademike ose joakademike, fitimprurëse ose jofitimprurëse, të huaja ose të vendit, që kanë ekspertizë dhe eksperiencë në organizimin e aktiviteteve të edukimit në vazhdim në fushën e shëndetësisë, sipas kriterëve të parashikuara nga institucionet akredituese.

4. Parimet dhe standardet

Edukimi në vazhdim bazohet në rolin e profesionistit për të zgjedhur dhe për të qenë aktiv në procesin e zhvillimit të tij profesional. Sistemi i ricertifikimit synon të nxisë dhe ndihmojë profesionistët e shëndetësisë në përmbushjen e nevojave të tyre për edukim sipas parimeve të mëposhtme:

Parimi 1. Profesionisti nxitet ta planifikojë vetë pjesëmarrjen në aktivitetet e edukimit në vazhdim, bazuar në qëllimin e praktikës së tij profesionale, nevojat e identifikuar dhe kompetencat e dëshiruara. Është e rëndësishme që profesionisti të shpenzojë aq kohë sa duhet për të siguruar ruajtjen e nivelit të ekspertizës në punën e tij të përditshme.

Parimi 2. Profesionisti zgjedh ato aktivitete që bazohen në nevojat e perceptuara nga ai vetë, si dhe ato që janë identifikuar nga vlerësime të tjera (jo të perceptuara prej tij).

Parimi 3. Aktiviteti i edukimit në vazhdim duhet të ketë lidhje me specialitetin, rolin profesional dhe përgjegjësitë që ka profesionisti në pozicionin aktual të punës.

Parimi 4. Profesionisti duhet të jetë i angazhuar për të ruajtur profesionalizmin gjatë gjithë kohës së ushtrimit të profesionit dhe në kujdesin që ofron, nëpërmjet ngritjes profesionale të vazhdueshme.

Parimi 5. Profesionisti është përgjegjës për zgjedhjen e aktiviteteve të edukimit në vazhdim, të metodave që përdor për të mësuar dhe për t'u aftësuar më tej, si dhe për

vlërësimin e rezultateve të arritura.

Parimi 6. Profesionisti nxitet që ta integrojë procesin individual të të mësuarit me atë të ekipit ku punon, të grupeve të kolegëve apo me atë të komunitetit të gjerë.

Parimi 7. Profesionistit duhet t'i krijohen mundësitë dhe kushtet e përshtatshme nga strukturat dhe institucionet shëndetësore për ndjekjen e aktiviteteve të edukimit në vazhdim.

Për më shumë informacion rreth mënyrës se si mund të keni një rol sa më aktiv në programin e ricertifikimit mund të shikoni botimet e tjera të QKEV-së, si: “Planifikimi individual i aktiviteteve të edukimit në vazhdim”, “Standardet e aktiviteteve të edukimit në vazhdim” dhe “Kudri rregullator për analizën e nevojave për trajnim”.

II. NJOHJE E PËRGJITHSHME ME PROGRAMIN E RICERTIFIKIMIT

I. Çfarë synon Programi i Ricertifikimit?

Programi i ricertifikimit është hartuar për të mbështetur, fuqizuar dhe promovuar zhvillimin e vazhdueshëm profesional të punonjësve të shëndetësisë. Ai ka dy objektiva kryesorë:

1. Të nxisë punonjësit e shëndetësisë që të ndjekin aktivitete të edukimit në vazhdim në përbushje të nevojave të tyre individuale, në funksion të praktikave më të mira profesionale dhe cilësisë më të lartë të shërbimit ndaj pacientit.
2. Të dokumentojë dhe regjistrojë kreditet e përfituara nga aktivitetet e edukimit në vazhdim në funksion të ricertifikimit të punonjësve. Në të ardhmen programi i ricertifikimit do të integrohet në procesin e rilicencimit të punonjësve të shëndetësisë.

2. Si është i organizuar Programi i Ricertifikimit?

Programi i ricertifikimit do të organizohet në cikle 5-vjeçare. Cikli i parë fillon në janar 2010 dhe përfundon në dhjetor 2014. Kërkesat e ciklit të parë të programit të ricertifikimit janë të reduktuara në krahasim me ato të cikleve që vijojnë, për shkak të vështirësive që paraqet vënia në jetë e këtij programi në shkallë kombëtare.

Profesionistët që do të përfshihen në këtë program janë mjekë, stomatologë dhe farmacistë, shtetas shqiptarë dhe të huaj, që ushtrojnë profesionin e tyre në Republikën e Shqipërisë, sipas legjislacionit në fuqi, në institucionet publike ose private të kujdesit shëndetësor parësor, dytësor dhe tretësor dhe ata të institucioneve akademike shëndetësore.

Në ciklin e parë të programit të ricertifikimit profesionistët e përfshirë në këtë program duhet të mbledhin një numër jo më të vogël se 150 kredite në 5 vjet, sipas kriterëve dhe procedurave që do të paraqiten më poshtë në këtë udhëzues. Në ciklet që vijojnë numri i krediteve të detyrueshme për t'u mbledhur brenda ciklit pesëvjeçar do të jetë 250.

Mjekët, stomatologët dhe farmacistët, të cilët do të fillojnë ta ushtrojnë profesionin e tyre (do të licencohen) pas datës së fillimit të ciklit të parë (janar 2010), duhet të përbushin kërkesat e programit të ricertifikimit nga 1 janari i vitit kalendarik pasues, duke mbledhur kreditet e nevojshme të fazës në të cilën ndodhet programi i ricertifikimit. Për shembull, profesionistët, të cilët do të fillojnë të ushtrojnë profesionin e tyre gjatë vitit 2012, duhet të mbledhin 40 kredite për vitin 2013 dhe 50 kredite për vitin 2014.

Mjekët, stomatologët dhe farmacistët, të cilët gjatë një viti kalendarik të ciklit të programit, ndërpresin punën për një periudhë 4-mujore ose edhe më gjatë, përjashtohen nga kërkesat e programit për atë vit kalendarik.

Mjekët, stomatologët dhe farmacistët, të cilët janë në pension dhe nuk ushtrojnë profesionin e tyre, nuk përfshihen në programin e ricertifikimit.


Mjekët, stomatologët dhe farmacistët, të cilët punojnë me kohë të pjesshme, duhet të plotësojnë të njëjtat kriterë të programit, si edhe ata që ushtrojnë profesionin e tyre me kohë të plotë.

Zbatimi i programit të ricertifikimit mbështetet në Dokumentin Rregullator për Ricertifikimin e profesionistëve të shëndetësisë, Dokumentin Rregullator për Akreditimin e aktiviteteve të edukimit në vazhdim , në ofrimin e aktiviteteve të ndryshme të edukimit në vazhdim dhe në pjesëmarrjen aktive të profesionistëve, për të përfituar nga aktivitetet e ofruara. Gjithashtu, aktorë të tjerë të rëndësishëm janë Instituti i Sigurimeve të Kujdesit Shëndetësor, institucionet shëndetësore dhe Qendra Kombëtare e Cilësisë, Sigurimit dhe Akreditimit të Institucioneve Shëndetësore.

Figura 1 paraqet ndërveprimin mes aktorëve kryesorë, mbi bazën e të cilit do të zbatohet programi i ricertifikimit.

Organi më i lartë vendimmarrës është BKRA-ja, ndërsa QKEV-ja do të menaxhojë teknikisht procesin, në bashkëpunim me aktorët e tjerë.

Figura 1.



3. Cilët janë hapat që duhet të ndjekin profesionistët për t'u përfshirë në programin e ricertifikimit?

Së pari, të gjithë mjekët, stomatologët dhe farmacistët, shtetas shqiptarë dhe të huaj, që ushtrjnë profesionin e tyre në Republikën e Shqipërisë, sipas legjislacionit në fuqi, në institucionet publike ose private të kujdesit shëndetësor (qendra shëndetësore, ambulanca, poliklinika, spitale, institucione akademike), duhet të regjistrohen në programin e ricertifikimit. QKEV-ja do të krijojë një regjistër elektronik, i cili do të ruajë të dhënat për të gjithë profesionistët e regjistruar. Këta profesionistë duhet të kontaktojnë QKEV-në si për regjistrimin e tyre në program, ashtu edhe për verifikimin e të dhënave përkatëse në lidhje me kreditet e përfituara nga aktivitetet e edukimit në vazhdim.

Së dyti, profesionistët duhet të marrin pjesë në aktivitete të ndryshme të edukimit në vazhdim, të zgjedhura nga ata vetë, nisur nga nevojat e tyre personale dhe institucionale dhe në përmbushje të kriterëve të kërkuara në programin e ricertifikimit; si dhe në varësi të aktiviteteve të ofruara gjatë një viti ose gjatë një cikli brenda ose/dhe jashtë vendit.

Kreditet e marra nga pjesëmarrja në këto aktivitete duhet të njihen dhe regjistrohen nga QKEV-ja, sipas procedurave të njohjes dhe regjistrimit të krediteve të përshkruara në vijim.

Së treti, mbi bazën e krediteve të regjistruara për secilin profesionist nga QKEV-ja, BKRA-ja vendos për ricertifikimin e tij dhe lëshon dëshminë përkatëse për profesionistët që kanë plotësuar kërkesat e programit.

Figura 2. Hapat e profesionistit për ricertifikim

1. Regjistrimi i profesionistit në regjistrin kombëtar të ricertifikimit .
2. Njohja dhe regjistrimi i krediteve personale sipas procedurave të përcaktuara qartë.
3. Ricertifikimi ose marrja e dëshmisë së ricertifikimit.

Në mënyrë më të detajuar këto hapa sqarohen më poshtë.

4. Cilat janë kriteret që duhet të plotësojnë profesionistët e përfshirë në Programin e Ricertifikimit?

- I. Kriteri kryesor për profesionistët e regjistruar në programin e ricertifikimit është **numri i krediteve** që ata duhet të mbledhin brenda një cikli 5-vjeçar, si dhe në secilin vit të ciklit.
 - ❖ Programi i ricertifikimit kërkon mbledhjen e 150 krediteve brenda një cikli 5-vjeçar. Ai parashikon një numër kreditesh të detyrueshëm dhe një numër kreditesh të rekomanduara për çdo vit.

Për shembull, numri i krediteve të kërkuara nga programi për ciklin e parë 5-vjeçar është 150. Numri i rekomanduar për vitin 2010 është 10, ndërsa numri minimal i detyrueshëm është 5. Kjo gjë bëhet për të lehtësuar profesionistët e përfshirë në program, duke u dhënë atyre mundësi të kompensojnë kreditet e munguara gjatë një viti.

Pra, në varësi të planeve të tyre individuale, profesionistët mund të mbledhin më pak se numri i rekomanduar, por jo më pak se gjysma e krediteve të rekomanduara për secilin vit kalendarik, me kusht që brenda ciklit të parë 5-vjeçar të programit të plotësohet numri i përgjithshëm prej 150 kreditesh (shih tabelën më poshtë).

Cikli i parë i Programit të Ricertifikimit 2010-2014	Numri i rekomanduar i krediteve	Numri minimal i detyrueshëm i krediteve
Viti 2010	10	5
Viti 2011	20	10
Viti 2012	30	15
Viti 2013	40	20
Viti 2014	50	25

- ❖ Profesionistët, të cilët zgjedhin të plotësojnë vetëm numrin minimal të detyrueshëm të krediteve, për një ose më shumë vite kalendarike të ciklit, duhet që brenda viteve të tjera të ciklit të plotësojnë 150 kreditet e kërkuara. Në të njëjtën mënyrë, profesionistët, të cilët e kalojnë numrin e rekomanduar të krediteve të një ose më shumë viteve kalendarike të ciklit, mund t'i transferojnë këto kredite në vitet

pasardhëse të të njëjtit cikël.

- ❖ Në rastet kur profesionisti nuk plotëson numrin e krediteve për secilin vit kalendarik ose numrin e përgjithshëm prej 150 kreditesh në 5 vjet, atëherë vlerësohet se profesionisti nuk ka përmbushur kërkesat e programit të ricertifikimit bazuar në ndjekjen e aktiviteteve të edukimit në vazhdim dhe duhet t’u nënshtrohet sanksioneve të parashikuara në Kapitullin III - 3 të këtij udhëzuesi.
- ❖ Në ciklin e dytë dhe në ciklet e tjera të programit të ricertifikimit numri total i krediteve të kërkuara është 250 kredite. Numri i krediteve të rekomanduara është 50 në vit dhe numri minimal i detyrueshëm është 30 kredite në vit.

Profesionistët janë të lirë të transferojnë kredite nga njëri vit kalendarik në tjetrin brenda secilit cikël, me kusht që të plotësojnë numrin minimal të detyrueshëm të tyre për secilin vit dhe numrin total 250 kredite në 5 vjet.

Cikli i dytë dhe në vijim	Numri i krediteve të rekomanduara	Numri minimal i detyrueshëm i krediteve
		250
Secili vit i cikleve në vijim	50	30

2. Një kriter i dytë është **numri i krediteve sipas kategorive të aktiviteteve** (shih pikën 5). Numri i nevojshëm i krediteve të edukimit në vazhdim që një profesionist i përfshirë në programin e ricertifikimit duhet të mbledhë sipas kategorive të aktiviteteve, është si më poshtë:

- ❖ Kreditet e përfituara nga aktivitetet e edukimit në vazhdim me temë të lidhur drejtpërdrejt me specialitetin e profesionistit duhet të përbëjnë të paktën 50% të numrit të përgjithshëm të krediteve të raportuara nga profesionisti për secilin vit kalendarik dhe për secilin cikël të programit të ricertifikimit.
- ❖ Kreditet e përfituara nga aktivitetet e vetëraportuara mund të përlogariten deri në 20% të numrit të përgjithshëm të krediteve të raportuara nga profesionisti për secilin vit kalendarik dhe për secilin cikël të programit të ricertifikimit.
- ❖ Pjesa tjetër e krediteve të nevojshme përcaktohet nga zgjedhja e lirë e profesionistit, në bazë të nevojave individuale.

Shembull: Një mjek, në fund të ciklit të parë, raporton një numër kreditesh të përfituara nga aktivitetet me temë të lidhur me specialitetin e tij që përbën 54% të numrit total të krediteve të ciklit; numri i krediteve të përfituara nga aktivitetet e vetëraportuara përbën 19% dhe kreditet e marra nga aktivitetet me temë të përgjithshme përbëjnë 27% të numrit total. Ai ka zgjedhur të marrë numrin e rekomanduar të krediteve gjatë vitit të parë dhe më shumë se numri i rekomanduar gjatë dy viteve të fundit të ciklit. Gjatë vitit 2014, ai ka marrë pjesë në një konferencë 2-ditore me 10 kredite, në një trajnim 1-javor me 20 kredite , ka lexuar 2 libra shkencorë nga fusha e specialitetit të tij, të botuar dy vitet e fundit dhe ka qenë anëtar i grupit të punës për një kërkim të realizuar nga departamenti i specialitetit të tij në Fakultetin e Mjekësisë; ka botuar një artikull në lidhje me këtë studim në një revistë mjekësore.

Viti kalendarik	Kreditet e përfituara nga AEV - fusha e specialitetit	Kreditet e përfituara nga aktivitetet e vetëraportuara	Kredite me zgjedhje të lirë	Numri i krediteve të raportuara për vit
2010	5	2	3	10
2011	10	3	2	15
2012	16	4	0	20
2013	20	9	16	45
2014	30	10	20	60
Numri i krediteve të raportuara në fund të ciklit	81	28	41	150

5. Si përfitohen kreditet?

Aktivitetet e edukimit në vazhdim dhe kreditet përkatëse

Profesionisti i regjistruar në programin e ricertifikimit mund të përfitojë kredite duke marrë pjesë në aktivitete të ndryshme të edukimit në vazhdim. Këto aktivitete ndahen në dy grupe kryesore sipas statusit të akreditimit.

Statusi i akreditimit	
1. Aktivitete të edukimit në vazhdim të akredituara paraprakisht	Aktivitete që lidhen drejtpërdrejt me specialitetin përkatës të profesionistit;
	Aktivitete me tema të tjera që lidhen me shëndetësinë, por jo domosdoshmërisht me specialitetin
2. Aktivitete të edukimit në vazhdim të pa akredituara paraprakisht	Aktivitete që lidhen drejtpërdrejt me specialitetin përkatës të profesionistit;
	Aktivitete me tema të tjera që lidhen me shëndetësinë, por jo domosdoshmërisht me specialitetin.

Profesionisti është i lirë të zgjedhë dhe të kombinojë aktivitete nga të dyja grupet, por duke iu përmbajtur kërkesave të programit të ricertifikimit.

5.1 Aktivitetet e akredituara paraprakisht

Aktivitetet e akredituara paraprakisht ndahen në:

- aktivitete të akredituara paraprakisht nga QKEV-ja: aktivitete që ofrohen dhe zhvillohen në vend, të cilat kanë marrë miratimin e QKEV-së dhe numrin e krediteve përkatëse;
- aktivitete të akredituara nga institucione të tjera akredituese: aktivitete të zhvilluara jashtë vendit ose në distancë, për të cilat QKEV-ja bën përkthimin e krediteve të huaja në kreditet e bazuara në kriteret e QKEV-së.

Numri i krediteve për pjesëmarrësit në këto aktivitete përlogaritet në bazë të kriterit I orë – I kredit.

Profesionistët, të cilët marrin pjesë në këto aktivitete si lektorë ose trajnerë, përfitojnë kredite që përlogariten në bazë të kriterit I orë – 1.5 kredite.

Aktivitetet kryesore të edukimit në vazhdim që përfshihen në këtë kategori janë trajnimi, konferenca, seminari, workshop-i etj. Tabela e mëposhtme paraqet aktivitetet më kryesore.

Aktiviteti	Përkufizimi
<i>Trajnimi</i>	Ky është një aktivitet në grup (20-25 vetë) ose individual, i orientuar kryesisht drejt praktikës profesionale, që gërsheton dhënien e leksioneve me metoda të tjera pedagogjike. Qëllimi është që pjesëmarrësit të përfitojnë njohuri, aftësi, shprehje ose kompetenca që u nevojiten për të kryer në mënyrë të kënaqshme detyrat dhe punën e tyre aktuale.
<i>Konferenca</i>	Ky është një aktivitet 1-2-ditor që mbahet mbi një temë të caktuar, zakonisht, i ofruar nga shoqata profesionistësh, ku ekspertë të fushës prezantojnë disa leksione ose studime të reja. Qëllimi i konferencës është të informojë audiencën profesionale mbi të rejtat e shkencës dhe teknologjisë në lidhje me profesionin në fjalë.
<i>Seminari</i>	Ky është një aktivitet mbi një çështje të caktuar profesionale, me një grup të vogël pjesëmarrësish (10-15), të cilët mësojnë duke marrë pjesë aktivisht. Gjatë seminarit diskutohen artikuj të caktuar, prezantohen studime të ndryshme, bëhen pyetje dhe debate në mënyrë joformale.

<i>Workshop-i</i>	Ky është një aktivitet i një grupi të vogël me orientim drejt zgjidhjes së problemeve, ku pjesëmarrësit përfshihen aktivisht në diskutime ose në kryerjen e një teknike, procedure apo manipulimi, të ndihmuar nga eksperti/trajneri. Qëllimi është që pjesëmarrësit të mësojnë duke provuar, gabuar dhe vetëkorrigjuar ose të korrigjohen me ndihmën e të tjerëve.
<i>Aktivitetet e edukimit në distancë*</i>	Janë aktivitetet që ofrohen për studentët, të cilët duan të mësojnë pa qenë të pranishëm fizikisht në auditor dhe në kohë reale. Pjesëmarrësit në këto aktivitete përdorin mjete të tilla, si: videokasetat, audiokasetat, postën elektronike, telefonin, video-konferencën, ueb-konferencën apo materiale të printuara.
<i>Programet universitare ose pas-universitare (p.sh. kurs kualifikimi)*</i>	Janë programe të ofruara nga institucionet akademike, brenda ose jashtë vendit.

** Këto aktivitete i përkasin vetëm kategorisë së aktiviteteve të akredituara paraprakisht nga institucione të tjera akredituese, përveç QKEV-së.*

Këto aktivitete mund t'i përkasin si grupit të parë të aktiviteteve me temë të lidhur me specialitetin e profesionistit, ashtu edhe grupit të dytë, me temë të përgjithshme mjekësore.

5.2 Aktivitete të edukimit në vazhdim të paakredituara paraprakisht

Kjo kategori aktivitetesh përfshin: a) aktivitetet individuale, kreditet e të cilave përlogariten nga institucioni akreditues (*kërkime/botime*), pas kërkesës së profesionistit për njohje kreditesh dhe b) aktivitete individuale, kreditet e të cilave përlogariten nga vetë profesionisti që i ka kryer ato (*aktivitete të vetëraportuara*).

5.2.a) Kërkimet/botimet nënkuptojnë përfshirjen e profesionistit në punë kërkimore, si: shkrimi i artikujve profesionalë, librave, si dhe zhvillimi i kurrikulave shkollore. Këto aktivitete përfitojnë kredite, për të cilat profesionistët e përfshirë në programin e ricertifikimit mund

të aplikojnë pranë institucionit akreditues, sipas procedurave të përshkruara në kapitullin III – 2 të këtij udhëzuesi. Përlogaritja e krediteve për aktivitetet e kësaj kategorie bëhet sipas tabelës së mëposhtme:

Aktiviteti	Numri i krediteve
Botim artikulli në revistë shkencore	deri në 20
Botimi i një artikulli në një revistë profesionale kombëtare me një autor	15
Botimi i një artikulli në një revistë profesionale kombëtare me dy autorë	10
Botimi i një artikulli në një revistë profesionale kombëtare me tre autorë	5
Botimi i një artikulli në një revistë shkencore ndërkombëtare me një autor	20
Botimi i një artikulli në një revistë shkencore ndërkombëtare me dy autorë	15
Botimi i një artikulli në një revistë shkencore ndërkombëtare me tre autorë	10
Botim kapitulli në libër	deri në 20
Botim kapitulli me një autor, deri 10 faqe	15
Botim kapitulli me një autor, > 10 faqe	20
Botim kapitulli me dy autorë, deri 10 faqe	10
Botim kapitulli me dy autorë, > 10 faqe	15
Botim libri	deri në 50
Botim libri me një autor	50
Botim libri me dy autorë	40
Botim libri me më shumë se dy autorë	25
Drejtim i botimit të një libri me më shumë se dy autorë	40
Kurrikulë universitare ose pasuniversitare	deri në 30
Kurrikulë universitare	
- Përgatitja e një kurrikule semestrale	15
- Përgatitja e një kurrikule njëvjeçare	25
Kurrikulë pasuniversitare	
- Përgatitja e një kurrikule semestrale	20
- Përgatitja e një kurrikule njëvjeçare	30

III. PROCEDURAT E RICERTIFIKIMIT

I. Si kryhet regjistrimi në Programin e Ricertifikimit

Mjekët, stomatologët dhe farmacistët, shtetas shqiptarë dhe të huaj, që ushtrojnë profesionin e tyre në Republikën e Shqipërisë, sipas legjislacionit në fuqi, në institucione publike ose private të kujdesit shëndetësor parësor, dytësor dhe tretësor dhe ata të institucioneve akademike shëndetësore, duhet të regjistrohen në programin e ricertifikimit në mënyrë elektronike ose pranë QKEV-së, në adresën e mëposhtme:

Qendra Kombëtare e Edukimit në Vazhdim
Rr. "Aleksandër Moisiu", nr.84, Tiranë, Shqipëri.
Tel: +355 4 2452286
e-mail:info@qkev.gov.al
www.qkev.gov.al

** Në faqen e internetit të QKEV-së do të gjeni Formularin e Regjistrimit në Programin e Ricertifikimit (shih shtojcën 1).*

** Në shtojcën 2 jepen disa modele të formularit të plotësuar të regjistrimit në Programin e Ricertifikimit.*

** Profesionistët e punësuar në më shumë se një institucion shëndetësor publik ose privat duhet të japin informacionin përkatës për secilin institucion gjatë plotësimit të formularit.*

QKEV-ja do të administrojë një regjistër kombëtar elektronik, i cili do të mbajë të dhëna për të gjithë profesionistët e shëndetësisë që ushtrojnë profesionin e tyre në Republikën e Shqipërisë, në institucione publike ose private. Për të gjithë profesionistët që bëjnë pjesë në kategorinë që mbulon programi i ricertifikimit në fazën fillestare (mjekë, stomatologë, farmacistë), regjistri do të përmbajë një dosje individuale, në të cilën QKEV-ja do të hedhë kreditet individuale të përlogaritura për secilin vit dhe secilin cikël. Mbi bazën e këtyre të dhënave do të kryhet ricertifikimi i profesionistit.

QKEV-ja do të synojë ta bëjë regjistrin e programit të ricertifikimit të aksesueshëm nga çdo profesionist në distancë.

Të gjithë mjekët, stomatologët dhe farmacistët janë të nxitur të kontrollojnë për emrin e tyre dhe të dhënat përkatëse në regjistrin kombëtar. Në rast se vërejnë mungesa ose pasaktësi, ata duhet t'i drejtohen institucionit përgjegjës dhe/ose QKEV-së.

Po kështu, tërheqim vëmendjen e të gjithë atyre profesionistëve, që ushtrojnë profesionin e tyre pas fillimit të vënies në punë të regjistrin kombëtar të ricertifikimit, që të interesohen për regjistrimin e tyre në Regjistrin Kombëtar të Ricertifikimit, pranë institucionit përgjegjës dhe/ose QKEV-së, në mënyrë që të përfshihen në këtë program.

2. Si regjistrohesh kreditet?

Njohja dhe regjistrimi i krediteve kryhet nga QKEV-ja, nëpërmjet regjistrimit në dosjen individuale elektronike të profesionistit të krediteve të përfituara prej tij në aktivitetet e edukimit në vazhdim.

Procedurat e njohjes dhe regjistrimit të krediteve ndryshojnë bazuar në llojin e aktivitetit të edukimit në vazhdim, nga i cili këto kredite janë përfitur.

2.1 Aktivitetet e edukimit në vazhdim të akredituara paraprakisht

2.1.a) Regjistrimi i krediteve nga aktivitetet e edukimit në vazhdim të akredituara paraprakisht nga QKEV-ja

Në rastet kur profesionisti i përfshirë në programin e ricertifikimit merr pjesë në një aktivitet të edukimit në vazhdim të akredituar paraprakisht nga QKEV-ja, raportimi i krediteve përkatëse është përgjegjësi e ofruesit të aktivitetit, i cili duhet të dorëzojë pranë QKEV-së listën e pjesëmarrësve në aktivitet (sipas procedurave të parashikuara në Dokumentin Rregullator për Akreditimin e Aktiviteteve të Edukimit në Vazhdim për Punonjësit e Shëndetësisë). Regjistrimi i krediteve në këtë rast bëhet në mënyrë automatike nga QKEV-ja, në dosjet individuale elektronike të të gjithë pjesëmarrësve.

Numri i krediteve të përfituara nga profesionisti është i njëjtë me numrin e krediteve të miratuara nga QKEV-ja për këtë aktivitet, në rastet kur pjesëmarrja është e plotë dhe, kur

pjesëmarrja është e pjesshme, numri i krediteve përlogaritet në bazë të kriterit I orë – I kredit.

Shembull: Një mjek familjeje ka marrë pjesë në Konferencën Kombëtare të Mjekësisë së Familjes zhvilluar në dy ditë, me 12 kredite. Ai ka qenë pjesëmarrës në konferencë ditën e parë dhe gjatë seancës së paradites së ditës së dytë. Numri i krediteve që i përlogariten është 9 (9 orë pjesëmarrje – 9 kredite).

Në rastet kur profesionisti ka marrë pjesë si lektor në aktivitetet e edukimit në vazhdim të akredituara paraprakisht nga QKEV-ja, kreditet, që do të regjistrohen në dosjen e tij individuale, do të përlogariten në bazë të kriterit I orë – 1.5 kredite.

Afati kohor:

Regjistrimi i krediteve të përfituara nga këto aktivitete nuk është përgjegjësi e profesionistit, por do të kryhet automatikisht nga QKEV-ja, në bashkëpunim me ofruesit. Për këtë gjë ofruesit e këtyre aktiviteteve duhet të dorëzojnë listat e pjesëmarrësve në aktivitet pranë QKEV-së, jo më vonë se 30 ditë pas përfundimit të aktivitetit. Ndërsa QKEV-ja i regjistron këto kredite në dosjet personale të pjesëmarrësve jo më vonë se 30 ditë nga dorëzimi i listave. Pra, brenda 60 ditëve nga data e përfundimit të aktivitetit, kreditet duhet të jenë të regjistruara në dosjen e secilit profesionist.

2.1.b) Regjistrimi i krediteve nga aktivitetet e edukimit në vazhdim të akredituara paraprakisht nga institucione të tjera, përveç QKEV-së

Në rastet kur profesionisti i përfshirë në programin e ricertifikimit merr pjesë në një aktivitet të edukimit në vazhdim të akredituar paraprakisht nga institucione të tjera akredituese, si programe universitare ose pasuniversitare të akredituara ose konferenca dhe seminare të akredituara, të zhvilluara jashtë vendit, atëherë kërkesa për njohjen dhe regjistrimin e këtyre krediteve duhet bërë individualisht nga profesionisti, pranë zyrave të QKEV-së. Dokumentet që duhet të paraqiten në këtë rast janë programi i aktivitetit dhe certifikata e ndjekjes ose diploma e përfituar prej tij, me numrin përkatës të krediteve. *Për shembull, një mjek/menaxher i një qendre shëndetësore, që ka marrë pjesë në kursin veror njëjavor me*

temë “Management and Leadership of Health Care Organizations”, ofruar nga Universiteti i Zvicrës Italiane, në Lugano, duhet të paraqesë këto dokumente:

Dokumentet që duhen paraqitur		Numri i krediteve të përfituara
Certifikata e pjesëmarrjes Certifikata e kryerjes së provimit (nëse ka)	Kopje	
Programi i detajuar i aktivitetit	Numri i orëve efektive : 45	45
Kreditet përkatëse	1.5 ECT	

Numri i krediteve të përfituara nga profesionisti në këtë rast përlogaritet në bazë të kriterit 1 orë – 1 kredit. Në rastet kur profesionisti ka marrë pjesë si lektor në aktivitetet e edukimit në vazhdim, atëherë përlogaritja e krediteve do të bëhet në bazë të kriterit 1 orë – 1.5 kredite. Pas njohjes së krediteve, QKEV-ja kryen regjistrimin e tyre në dosjen individuale elektronike të profesionistit.

Afati kohor:

Për regjistrimin e krediteve të përfituara nga aktivitete të edukimit në vazhdim të akredituara paraprakisht nga institucione të tjera akredituese, shihni faqen 27.

2.2 Aktivitetet e edukimit në vazhdim të paakredituara paraprakisht

2.2. a. Regjistrimi i krediteve nga botimet dhe kërkimi shkencor

Në rastet kur profesionisti i përfshirë në programin e ricertifikimit merr pjesë në aktivitete të kësaj kategorie, atëherë kërkesa për njohjen dhe regjistrimin e krediteve duhet bërë individualisht nga profesionisti, pranë zyrave të QKEV-së. Kërkesa shoqërohet me dokumentacionin përkatës si më poshtë:

Aktiviteti individual	Dokumentacioni i kërkuar
1. Botimi i një artikulli	Fotokopje e kapakut të revistës shkencore. Fotokopje e artikullit.
2. Botim i një kapitulli në një libër	Fotokopje e kapakut të librit. Fotokopje e faqes së parë të kapitullit.
3. Botim i një libri	Fotokopje e kapakut të librit dhe faqes së autorëve.
4. Përgatitje kurrikule universitare dhe pasuniversitare	Fotokopje e faqes së parë të kurrikulës ku janë përshkruar përmbajtja dhe autori/ët. Vërtetim nga fakulteti përkatës.

Numri i krediteve të përfituara nga profesionisti në këtë rast përlogaritet në bazë të kriterëve të paraqitura në pikën 5.2.a). Pas llogaritjes së krediteve, QKEV-ja kryen regjistrimin e tyre në dosjen individuale elektronike të profesionistit.

Afati kohor:

Për regjistrimin e krediteve të përfituara në aktivitete të edukimit në vazhdim të akredituara paraprakisht nga institucione të tjera akredituese dhe nga aktiviteteve individuale të edukimit në vazhdim (aktivitetet e përshkruara në pikën 2.1.a dhe 2.2.a), profesionisti duhet të aplikojë për njohjen dhe regjistrimin e krediteve pranë QKEV-së, para datës 30 shtator për aktivitetet e zhvilluara në 6-mujorin e parë të vitit kalendarik dhe para datës 31 dhjetor për aktivitetet e zhvilluara në 6-mujorin e dytë të vitit kalendarik. Në të kundërt, kreditet do të regjistrohen në dosjen individuale dhe do të përlogariten si kredite të përfituara në vitin pasardhës. QKEV-ja i regjistron këto kredite në dosjet përkatëse të profesionistit brenda 30 ditëve nga dita e dorëzimit të kërkesës dhe dokumentacionit të nevojshëm.

2.2. b. Regjistrimi i krediteve nga aktivitetet e vetëraportuara

Raportimi i krediteve të aktiviteteve të vetëraportuara kryhet në mënyrë individuale nga profesionisti përmes një formulari të hartuar nga QKEV-ja për këtë qëllim, i cili mund të dorëzohet në mënyrë elektronike ose pranë zyrave të QKEV-së. Në këtë formular profesionisti duhet të deklarojë programet e multimedias, studimin e literaturës profesionale ose vizitat studimore që ka kryer gjatë një viti kalendarik, në funksion të përmbushjes së nevojave të tij profesionale, si dhe orët aktive të përfshirjes së tij në këto aktivitete. Kopja e formularit të vetëraportimit të aktiviteteve të edukimit në vazhdim gjendet në shtojcën 3 të këtij udhëzuesi.

Aktiviteti	Numri i krediteve
1. Leximi i artikullit “ <i>High-potency cannabis and the risk of psychosis</i> ”, autorët: <i>Marta Di Forti, Craig Morgan, Paola Dazzan</i> etj, në <i>The British Journal of Psychiatry</i> , December 2009.	0.5
2. Leximi i librit “ <i>Current Medical Diagnosis & Treatment 2010</i> ”, autori <i>McPhee, Stephen</i> . Edition 49, 2009.	3
3. Leximi i artikullit “ <i>First birth using PGD to save baby from rhesus blood disease</i> ”. Burimi: http://www.doctorslounge.com/fertility/articles/pgd/pgd_rhesus/index.htm .	0.5
4. Përdorimi i DVD-së “ <i>Exploring the Heart A 3D Overview of Anatomy and Pathology CD ROM</i> ”, SKU: PA-1904369340, ISBN: 190436934, 2008	
5. Vizitë studimore në <i>National Hospital for Neurology and Neurosurgery, University College London Hospital NHS Trust, Londër, Angli</i> . Periudha e qëndrimit 20.08 – 30.08. 2010.	
6. Pjesëmarrje në kërkimin “Vlerësimi i nevojave për trajnim të profesionistëve të shëndetit publik në Shqipëri”, kryer nga Instituti i Shëndetit Publik. Roli në këtë studim lidhet me administrimin e pyetësorëve.	4
7. Plotësimi i planifikimit individual të aktiviteteve të edukimit në vazhdim	2

Afati kohor:

Pas njohjes së krediteve, QKEV-ja kryen regjistrimin e tyre në dosjen individuale elektronike të profesionistit. Për regjistrimin e krediteve të përfituara nga aktivitete të vetëraportuara, profesionisti duhet të plotësojë formularin përkatës, nëse është i nevojshëm, vetëm një herë për secilin vit kalendarik të ciklit, përpara datës 15 dhjetor.

Afatet kohore të QKEV-së:

QKEV-ja kryen procedurat e njohjes dhe regjistrimit të krediteve në dosjen individuale të profesionistit brenda një afati kohor jo më të gjatë se 30 ditë nga data e dorëzimit të dokumentacionit të nevojshëm nga ana e ofruesit ose profesionistit.

Procedurat e regjistrimit të krediteve të përfituara hidhen në dosjet individuale deri në datën 31 janar të vitit pasardhës, datë pas së cilës QKEV-ja duhet të raportojë pranë Bordit Kombëtar të Ricertifikimit dhe Akreditimit (BKRA) informacionin mbi statusin e secilit profesionist në programin e ricertifikimit për vitin e kaluar kalendarik.

3. Ricertifikimi i profesionistëve

Në fund të secilit cikël 5-vjeçar të programit të ricertifikimit, QKEV-ja paraqet në BKRA dosjet individuale me numrin total të krediteve të përfituara dhe informacionin e nevojshëm në lidhje me plotësimin e kriterëve të programit të ricertifikimit për çdo profesionist. Mbi bazën e këtij informacioni BKRA-ja pajis të gjithë profesionistët që kanë përbushur kërkesat e programit me një dëshmi që vërteton përbushjen e kërkesave të programit, kreditet përkatëse dhe kalimin në ciklin pasues të programit.

Në mënyrë që të gjithë profesionistët të nxiten për të plotësuar kriteret e programit të ricertifikimit, QKEV-ja informon BKRA-në mbi statusin e secilit profesionist, i cili, në një fazë të caktuar të ciklit, nuk i ka përbushur kriteret e programit. BKRA-ja, bazuar në informacionin e dorëzuar nga QKEV-ja, ngarkon urdhrat e profesionistëve ose institucionet punëdhënëse që të njoftojnë të gjithë ata profesionistë të cilët nuk i kanë përbushur kriteret e parashikuara. Nëse, edhe pas njoftimit, profesionisti nuk e ndryshon statusin e tij

KËSHILLA PRAKTIKE

Për profesionistët e përfshirë në programin e ricertifikimit.....

- ❖ Kontaktoni QKEV-në për t'u regjistruar në Regjistrin Kombëtar të Ricertifikimit.
- ❖ Verifikoni regjistrimin tuaj në Regjistrin Kombëtar të Ricertifikimit.
- ❖ Verifikoni saktësinë dhe vërtetësinë e të dhënave të regjistruara në dosjen tuaj individuale.
- ❖ Në rastet kur vini re mospërputhje në të dhënat e regjistruara në dosjen tuaj individuale, drejtohuni në zyrat e QKEV-së dhe bëni një kërkesë për ndryshimin e tyre¹. Kërkesa shoqërohet me certifikatat përkatëse dhe kopjet e formularëve të aktiviteteve të vetëraportuara.
- ❖ Në rast se kërkesa juaj nuk pranohet nga zyrat e QKEV-së, mund të ankoheni pranë BKRA-së për një zgjidhje më të mirë të rastit tuaj.
- ❖ Ruani certifikatat, diplomat e pjesëmarrjes në aktivitetet e edukimit në vazhdim deri në të paktën 5 vjet.
- ❖ Ruani kopjet e formularëve të plotësuar për aktivitetet e vetëraportuara deri në të paktën 5 vjet.
- ❖ Plotësoni sipas udhëzimeve të paraqitura në këtë udhëzues formularin e aktiviteteve të vetëraportuara.
- ❖ Udhëhiquni nga parimet dhe standardet e prezantuara në hyrje në këtë udhëzuesi, me qëllim përmbushjen e nevojave tuaja individuale, në funksion të praktikave më të mira profesionale dhe cilësisë më të lartë të shërbimit ndaj pacientit.
- ❖ Këshillohuni me “Dokumentin e planifikimit individual të aktiviteteve të edukimit në vazhdim”, për të bërë planet tuaja vjetore dhe 5-vjetore.

¹ Përpara se të bëni kërkesën për ndryshim, sigurohuni që nuk janë respektuar procedurat dhe kriteret e parashikuara në këtë udhëzues.

Shtojca I

Formular regjistrimi në Programin e Ricertifikimit

Emri, Atësia, Mbiemri: _____

Datëlindja: ____ / ____ / ____
 Data Muaji Viti

Profesioni/Specialiteti: _____

Institucioni: _____

Adresa _____

Kontakte personale:(tel)_____ (e-mail)_____



*Pasi të plotësoni formularin mund ta dërgoni me postë:
Qendra Kombëtare e Edukimit në Vazhdim
Rr. Aleksandër Moisiu, Nr. 84
Tiranë, Shqipëri
ose në adresën elektronike: info@qkev.gov.al*

Shtojca 2

Modele të formularit të plotësuar të regjistrimit në Programin e Ricertifikimit

Emri, Atësia, Mbiemri: Ardit Osman Hoxha

Datëlindja: 13 / 05 / 1967

Data Muaji Viti

Profesioni/Specialiteti: Mjek / Kardiolog

Institucioni: Qendra Spitalore Universitare “Nënë Tereza” / Spitali Amerikan (me kohë te pjesshme).

Adresa: QSUT, Reparti i Kardiologjisë, Rr Dibrës, 372, Tiranë
Spitali Amerikan, pranë Spitalit Ushtarak, Laprakë, Tiranë

Kontakte personale: (tel) 0684033194 (e-mail) a.hoxha@gmail.com

Emri, Atësia, Mbiemri: Alketa Shaban Koçi

Datëlindja: 07 / 12 / 1971

Data Muaji Viti

Profesioni/Specialiteti: Mjeke / Stomatologe

Institucioni: Klinika private Koçi (Personi i licencuar Alketa Koçi)

Adresa: Lagja Kala, nr 23. Elbasan

Kontakte personale: (tel) +355 54 2 25367 (e-mail) koci71@yahoo.com

Emri, Atësia, Mbiemri: Drita Haxhi Hyseni

Datëlindja: 12 / 04 / 1960

Data Muaji Viti

Profesioni/Specialiteti: Farmaciste

Institucioni: Farmaci private (Personi i licencuar Haxhi Hyseni)

Adresa: Farmacia nr. 3, Rr. Themistokli Gërmenji, Korçë.

Kontakte personale: (tel) 0672450421 (e-mail) hysenid@hotmail.com

Shtojca 3

Formulari i vetëraportimit të aktiviteteve të edukimit në vazhdim

Emër _____	Nr. i regjistrimit <input style="width: 80px;" type="text"/>
Emri i babait _____	
Mbiemri _____	
Adresa e punës _____	
Pozicioni i punës _____	
Fusha e specialitetit _____	Data e plotësimit <input style="width: 80px;" type="text"/>
Periudha Kohore	

Aktiviteti i kryer	Të dhënat e aktivitetit	Numri i krediteve për aktivitet
1. Lexim artikulli shkencor	Shëno titullin, autorin, vitin e botimit, burimin	0.5
• • •		
2. Lexim libri mjekësor	Shëno titullin, autorin, vitin e botimit, burimin	3
• • •		

3. Përdorimi i një DVD/CD	Shëno titullin, autorin, vitin e botimit, burimin	0.5
• •		
4. Vizitë studimore	Shëno institucionin/ departamentin shëndetësor, shtetin, kohëzgjatjen	5
• 5. Pjesëmarrje në kërkim/ studim •	Shëno titullin e studimit, autorin/ët, vitin, rolin tuaj në këtë aktivitet	4
6. Plotësimi i planifikimit individual të aktiviteteve të edukimit në vazhdim	Shoqëro me një kopje të formularit të vetëvlerësimit dhe planifikimit	2

Deklaroj se aktivitetet e mësipërme janë raportuar me vërtetësi.

Nënshkrimi

BOTIME TE TJERA TE QKEV-së:

Dokumenti rregullator për akreditimin e aktiviteteve të edukimit në vazhdim për profesionistët e shëndetësisë, 2009.

Dokumenti rregullator për ricertifikimin e profesionistëve të shëndetësisë, 2009.

Standardet e aktiviteteve të edukimit në vazhdim për profesionistët e shëndetësisë, 2009.

Udhëzues për vlerësimin e brendshëm të aktiviteteve të edukimit në vazhdim për profesionistët e shëndetësisë, 2009.

Udhëzues për procedurat dhe kriteret e akreditimit të aktiviteteve të edukimit në vazhdim, 2009.

Kuadri rregullator për analizën e nevojave për trajnim – Instituti Kombëtar i Shëndetit Publik, Québec, 2008.

Këto botime mund t'i gjeni në faqen e internetit të QKEV-së

www.qkev.gov.al

UDHËZUES

mbi Programin e Ricertifikimit
për profesionistët e shëndetësisë



Rr."Aleksandër Moisiu", Nr.84, Tiranë

Tel: +355 4 2452286; e-mail: info@qkev.gov.al; www.qkev.gov.al